



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 802/1 Prot.

Vlorë më, 14. 05. 2021

VENDIM

Nr. 17, datë 11. 05. 2021

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË DHE
PËRJASHTIMET NGA TARIFA**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 23. 01. 2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21. 12. 2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, të ndryshuar", VKM nr. 40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 269, datë 29. 03. 2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me shkresën nr. 786 prot datë 07. 05. 2021, shkresa nr. 614 prot, datë 13. 04. 2021, shkresa nr. 649/1 prot, datë 20. 04. 2021 në mbledhjen e datës 11. 05. 2021 Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë sipas shkresës nr. 649/1 prot, datë 20. 04. 2021:
 - dhënien e bursës për 1(një) student, për vitin akademik 2020- 2021, me efekt financiar 49, 000 lekë.
 - përjashtimin nga tarifa e shkollimit për 1 (një) student, për vitin akademik 2020- 2021 me efekt financiar 20, 000 lekë.
2. Të miratojë sipas shkresës nr. 786 prot, datë 07. 05. 2021:
 - dhënien e bursës për 2 (dy) studentë, për vitin akademik 2020- 2021, me efekt financiar 165, 000 lekë.
 - përjashtimin nga tarifa e shkollimit për 2 (dy) studentë, për vitin akademik 2020- 2021, me efekt financiar 30, 000 lekë.
3. Të miratojë sipas shkresës 614 prot, datë 13. 04. 2021 :
 - dhënien e bursës për 10 (dhjetë) studentë, për vitin akademik 2020- 2021, me efekt financiar 545, 567 lekë.
 - përjashtimin nga tarifa e shkollimit për 11 (njëmbëdhjetë) studentë, për vitin akademik 2020- 2021, me efekt financiar 220, 000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

- reduktimin nga tarifa e shkollimit për 8 (tetë) studentë, për vitin akademik 2020-2021, me efekt financiar 258, 000 lekë.
4. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohen Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. ERVIS MOCKA

